REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 1260/22
Nr. i fq. / Br. st - 02 -
Data: / Datum 12.10.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

stichting BOZporus

OJQ"BOZporus" Holandë

Komuna e Vushtrrisë

---

OJQ BOZporus nga Holanda, me përaqësues Z. Ardian Gashi
dhe

Komuna e Vushtrrisë, me adresë Sheshi "Ahmet Krasniqi", nr.10, 42000, Vushtrri, me përfaqësues ligjor Kryetari Z. Ferit Idrizi

lidhin këtë,

# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*Projekti: Renovimi i SHFMU"Hajrullah Shala"Akrashticë*

**Neni 1: Lënda e marrëveshjes**

OJQ BOZporus nga Holanda, me përaqësues Z. Ardian Gashi *dhe*
Komunës së Vushtrrisë, me adresë Sheshi "Ahmet Krasniqi", nr.10, 42000, Vushtrri, me përfaqësues ligjor Kryetari Z. Ferit Idrizi

**Neni 2: Projekt i** OJQ BOZporus nga Holanda

OJQ BOZporus nga Holanda është duke rinovuar objektin e vjetër të shkollës dhe funksionalizimin e plotë. OJQ BOZporus do ta ndërtoj një aneks për toalete, do ti renovoj muret, nivelizimin e brendshëm fasadimin dhe ngjyrosjen e shkollës, ndërrimin e dyerve të brendshme, furnizimin me tabela, ndërsa për investime tjera mvaret prej donacionit të OJQ-së

**Neni 3: Përgjegjësitë e** OJQ BOZporus nga Holanda

OJQ BOZporus nga Holanda zotohet se do t'i kryej të gjitha punët të cekura më lart në nenin 2 të kësaj marrëveshje.



**Neni 4: Përgjegjësitë e Komunës së Vushtrrisë**

Komuna e Vushtrrisë në bashkëfinancim do të financoj vendosjen e dritareve të reja të reja në vlerë prej 6.492.54 euro .

**Neni 5: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet, kontradiktat apo pretendimet që ngritën apo ndërlidhen me këtë marrëveshje do të zgjidhen në mënyrë miqësore, përmes negociatave mes palëve, brenda 30 ditëve.

Palët dakordohen specifikisht që çfarëdo shkelje materiale e kësaj marrëveshje mund të dërgojë në ndërprerjen e saj të menjëhershme, me kusht që palët fillimisht të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen në mënyrë miqësore.
Nëse cilësdo palë i është shkaktuar dëmi si rezultat i mosrespektimit të kësaj marrëveshje, pala dëmtuese duhet të kompensojë, ose dëmshpërblej palën tjetër për masën e dëmit të pësuar.

Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje përmes negociatave, vendi i juridiksionit është Prishtina dhe ligji i zbatueshëm është legjislacioni i Kosovës.

Vushtrri më 12.10.2022

Palët kontraktuese:

Z. Ferit Idrizi Kryetar i Komunës

Z. Ardian Gashi OJQ"BOZporus